

NJOFTIM PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Furnizim

Procedure për kuotim çmimesh

Në përputhje me Nenin 39 të “Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (1 dhjetor 2024)

Datë: 17.07.2025

I. BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS (BQK)

Adresa: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

II. LËNDA E KONTRATËS

II.1. Titulli i kontratës i dhënë nga BQK:

“Furnizim me pjesë rezervë për modulet e lidhjes të makinës së keshit”

II.2 Nr. i Prokurimit: “BQK 25 046 134”

III. LLOJI I PROCEDURËS: “Procedurë për kuotim çmimesh”

(Në përputhje me nenin 13 të Rregullës për prokurimin në BQK)

IV. NUMRI I TENDERUESVE: 1 (një)

V. KRITERI PËR DHËNIEN E KONTRATËS

“Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët” (Në përputhje me nenin 34 të Rregullës për prokurimin në BQK)

VI. DHËNIA E KONTRATËS PËR FURNIZIM

VI.1 Emri i tenderit fitues: “PANAMIC ICT” L.L.C, Adresa: Prishtinë, Republika e Kosovës

VI.2 Vlera kontratës sipas çmimit të ofertës: 6,756.00 Euro.

VII. ANKESAT

Në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (1 dhjetor 2024), respektivisht sipas Neni 48 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar¹ me këtë procedurë mund të parashtrojë ankesë pranë Bankës

¹ Sipas paragrafit 1.26 të Nenit 2 të Rregullës për Prokurimin në BQK, “palë e interesuar” klasifikohet operatori ekonomik që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i një aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga Banka Qendrore në raport me një kontratë të prokurimit

Qendrore: Rr. "Garibaldi" 33, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t'u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.